

Përfaqësuesi tatimor

Pagesa e TVSH-së nga marrësi i shërbimit

Referuar përcaktimeve në Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2019 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas parimit të përgjithshëm, personi përgjegjës për të paguar TVSH-në në Shqipëri, është personi i tatueshëm që furnizon shërbimin.

Megjithatë, në rastin kur ky person përgjegjës nuk është i regjistruar për TVSH-në në Shqipëri dhe marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm, i regjistruar për TVSH-në në Shqipëri, atëherë është marrësi i shërbimit, personi përgjegjës për të paguar TVSH-në. Ky person e paguan TVSH-në duke aplikuar ngarkesën e kundërt (reverse-charge).

Pagesa e TVSH-së nëpërmjet përfaqësuesit tatimor

Nëse marrësi i këtij shërbimi nuk është një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në në Shqipëri, atëherë furnizuesi i shërbimit cakton një përfaqësues tatimor për të paguar TVSH-në, në Shqipëri.

Kushtet e përfaqësuesit tatimor:

- 1 Vendi i furnizimit të shërbimit është në Shqipëri;
- 2 Furnizuesi i këtij shërbimi (person përgjegjës për pagesën e TVSH-së) është një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në Shqipëri;
- 3 Vendi në të cilin duhet të paguhet TVSH-ja;

Atëherë personi i tatueshëm furnizues cakton një përfaqësues tatimor për të paguar TVSH-në, përveçse kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm në Shqipëri.

Përfundim nga detyrimi për përfaqësues tatimor

Në rast të kundërt, nëse TVSH-ja nuk paguhet prej përfaqësuesit tatimor për rastet e mësipërme, detyrohet ta paguajë TVSH-në në Shqipëri marrësi i shërbimit, i cili ka banesën e përhershme ose zakonisht banon në Shqipëri.

Modalitetet e përfaqësuesit tatimor

Kushti kryesor është që personi që caktohet si përfaqësues tatimor, duhet të jetë një person i tatueshëm në Shqipëri. Për qëllime të përmbushjes së detyrimit si përfaqësues tatimor, çdo person i tatueshëm që caktohet si i tillë duhet të regjistrohet më vete me një numër identifikimi të ri, si përfaqësues tatimor. Ky person i emëruar si përfaqësues tatimor është personalisht përgjegjës, për të përmbushur të gjitha detyrimet, përfshirë çdo gjobë a dënim, për të cilat detyrohet personi që përfaqëson dhe gëzon gjithashtu të gjitha të drejtat e personit që përfaqëson.

KUJDES!

Nëse personi që detyrohet, nuk emëron një përfaqësues tatimor, të gjitha detyrimet dhe penalitetet në ngarkim të tij do të paguhen nga përfituesi vendas i furnizimit.

Regjistrimi dhe çregjistrimi i përfaqësuesit tatimor

Procedura për regjistrimin dhe çregjistrimin e përfaqësuesit tatimor zbatohet siç është përcaktuar në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Personat që regjistrohen si përfaqësues tatimorë përmbushin detyrimet në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit (librave të shitjes dhe librave të blerjes), deklaramentit, faturimit, etj., si çdo person tjetër i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në.